



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200301/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandime për riorganizimin dhe vënien në punë në mënyrë më eficiente të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor, nxjerrja e përgjegjësive dhe dhënia e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

TIRANË

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

REC, MALËSI E MADHE

Për dijëni: z. Imer JUPA

INSTITUCIONI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

REC, MALËSI E MADHE

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 03.01.2022 ka bërë ankesë i dënuari Imer Jupa, i cili pretendon se, në datë 13.02.2022, rreth orës 19:30, është dhunuar nga grupi i sigurisë së IEVP Reç, në ambientet e dhomës nr.15. Gjithashtu, ai ka denoncuar gardianët e policisë me iniciale L.S, J.P, GJ.M dhe A.D për dhunën e ushtruar ndaj tij pa asnjë arsye.

Për verifikimin e kësaj ankese janë kryer veprimet hetimore si: marrja e deklarimeve me shkrim nga i dënuari Imer Jupa dhe bashkëvuajtësi e tij i dënuari Jetmir Llanaj; këqyrja e tij fizike; administrimi i dokumentacionit që lidhet me ngjarjen (libri i pasqyrimin të shërbimit, shënime të infermerit gjatë kryerjes së shërbimit, libri i protokollit, propozimi për sistemimin në dhoma, përmbledhja e daljes nga Qendra Spitalore e Burgjeve, regjistri i masave disiplinore, raport incidenti, libri i aktivitetit 24 orësh); këqyrja e kamerave të sigurisë së IEVP Reç, Malësi e Madhe, Shkodër.

Në përfundim të hetimit, pasi analizuam në tërësi materialin e mbledhur, arritëm në përfundimin se pretendimi i të dënuarit Imer Jupa nuk mund të provohet, por u vunë re disa probleme në lidhje me garantimin e të drejtave të të burgosurve, dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla.

Nga këqyrja fizike që ndihmëskomisioneri i Institucionit të Avokatit të Popullit i bëri të dënuarit Imer Jupa në datën 18.03.2022 konstatoi se, ai kishte një gërvishtje të lehtë, në anën e djathtë të qafës, por ishte për shkak vetëdëmtimi që i dënuari i kishte shkaktuar vetvetes nga stresi. Dinamika e ngjarjes, profili psiko-social i të dënuarit dhe sjellja e tij në institucion përforcojnë variantin e IEVP-së që është si vijon: *“Shtetasi Imer Jupa është i burgosur me probleme të çrregullimit të personalitetit, me sjellje impulsive dhe herë pas here bën veprime të pakontrolluara, konfliktohet me bashkëvuajtësit e tij, siç është dhe rasti konkret, si dhe provokon të dënuarit e tjerë me fjalë fyese”*.

Sipas deklarimit të të dënuarit Imer Jupa, në datë 13.02.2022, rreth orës 19:30, në ambientet e godinës nr.2, dhoma nr.10, sektori 2, kati i parë, ka patur një konflikt me bashkëvuajtësin e tij, të dënuarin Jetmir Llanaj, të cilin e njihte përpara ardhjes së tij në IEVP Reç. Gjithashtu, i dënuari ka theksuar se atë ditë ka patur një kontroll nga Forcat Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, në vijim FODPB, për sende të ndaluara në këtë institucion. Pas mbarimit të kontrollit, ka rezultuar se në dhomën e të dënuarit Imer Jupa nuk janë gjetur sende të ndaluara dhe Forcat Operacionale janë larguar. Gjithashtu, i dënuari ka sqaruar se, më pas është thirrur nga bashkëvuajtësi i tij, i dënuari Jetmir Llanaj, në dhomën tij, dhe i ka thënë je spiun, pse më ke sjellë FADAP për kontroll. Në këtë kohë, i dënuari Jetmir Llanaj, e ka tërhequr shtetasin Imer Jupa për ta futur brenda në dhomën e tij, ku e ka goditur me grushta dhe shkelma në trup dhe në kokë për rreth 3 deri 4 minuta. Në këto momente ka ardhur grupi i gatshëm dhe i ka shoqëruar të dy të dënuarit në dhoma izolimi. Sipas të burgosurit, gjatë shoqërimit nëpër korridore dhe deri në dhomat e izolimit nuk ka patur dhunë, por në momentin e futjes në dhomë, kanë hyrë gardianët Lorenc Sterkaj, Jurgen Peraj, Gjoniko Markvukaj dhe Alban Ndreca, të cilët e kanë goditur atë me grushta në fytyrë dhe shkelma në pjesë të trupit, si dhe e kanë ofenduar me fjalë fyese. Në vijim i burgosuri ka sqaruar se nuk e ka ngritur shqetësimin për dhunë të ushtruar ndaj tij nga grupi i sigurisë së IEVP Reç, tek Komisioni për Masat Disiplinore apo përpara mjekut të institucionit, duke deklaruar se nuk ka besim tek ata. Po ashtu, ai deklaroi se disa herë ka bërë tentativë për vetëdëmtim për arsye të stresit dhe të mërzisë. I dënuari Imer Jupa kërkon rikthimin në sektorin ku ka qenë për të vijuar vuajtjen e dënimit.

Ky episod, por edhe episode të tjera të përsëritura janë pasqyruar në informacionin e përpiluar nga shefi i policisë dhe specialisti i regjimit. Pas incidentit të datës 13.03.2022, që kemi hetuar, ka patur edhe incidente të tjera, pasi i dënuari ka vazhduar qëndrimin e tij agresiv ndaj bashkëvuajtësve të tij.

Në raport incidentin e datës 15.02.2022, shkruhet se në datën 13.02.2022, ora 19:10, pasi përfundoi kontrolli i sendeve të ndaluara nga Forcat Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në vijim (FODPB), në dhomat e tyre të dënuarit po sistemonin rrobat, pasi ishin nxjerrë në korridor nga (FODPB) për kontroll. I dënuari i dhomës nr.10, Imer Jupa është afruar tek dhoma nr.1, ku ndodhej i dënuari Jetmir Llanaj, për ta pyetur nëse i kanë bërë rrëmujë në dhomë. Ndërkohë i dënuari Jetmir Llanaj i ka kërkuar të largohet nga dhoma e tij. Në bisedë e sipër, i dënuari Imer Jupa e ka goditur të dënuarin Jetmir Llanaj dhe më pas janë konfliktuar në korridor, ku janë përfshirë edhe të dënuarit e tjerë. Për këtë situatë është njoftuar menjëherë grupi i sigurisë dhe më pas ata kanë bërë shoqërimin e të dënuarve në dhomat e izolimit. Stafi mjekësor, edukativ dhe policor është shprehur se, i dënuari Imer Jupa është person problematik dhe nuk bashkëpunon me ata, por kryen veprime të dhunshme dhe krijon incidente për vetëflijmim me qëllim për tu viktimizuar dhe për të kërkuar transferimin e tij në një IEVP tjetër.

Referuar dokumentacionit të administruar dhe shënimit të infermierit, gjatë kryerjes së shërbimit të datës 12.02.2022 dhe 13.02.2022, i dënuari Imer Jupa nuk ka referuar për raste dhune si dhe nuk ka marrë ndonjë shërbim shëndetësor për mjekim, por me datë 14.02.2022, në orën 11:40 minuta, ai ka marrë ilaçin “Diazepam”, i cili përdoret për qetësim, gjumësjellje etj. (Ngjarja ka ndodhur me datë 13.02.2022, ndërsa vizita tek infermieri apo shpërndarja e medikamenteve është bërë me datë 14.02.2022, një ditë më vonesë). Në nenin 102 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet se: “IEVP-të sigurojnë shërbim shëndetësor pa ndërprerje, nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor”, dhe se “Çdo kontroll duhet të dokumentohet në kartelën shëndetësore të të paraburgosurit dhe të të dënuarit, e cila është pjesë e dosjes mjekësore të tij.” Në këtë rast kontrolli mjekësor nuk është ushtruar në kohë dhe nëse i dënuari ka refuzuar të vizitohet nga stafi shëndetësor, ky fakt duhet të ishte pasqyruar në dokumentacion.

Pamjet filmike të kamerave të sigurisë, për aq sa lejojnë të kuptohet, nuk përputhen plotësisht me deklaratimet e të dënuarit Imer Jupa. Në kamera duket që, në orën 18:30, të datës 13.02.2022, në ambientet e godinës nr.2, dhoma nr.10, sektori 2, kati i parë hyjnë Forcat Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kontroll të sendeve të ndaluara. Ata fillimisht hyjnë në dhomën nr.10 ku ndodhej i dënuari Imer Jupa dhe më pas vijojnë me dhomën nr. 8 dhe nr.17. Pas kontrollit FODPB janë larguar. Në orën 18:58 minuta, i dënuari Imer Jupa shkon në dhomën nr.8, të të dënuarit Jetmir Llanaj

dhe pas disa sekondave ata konfliktohen fizikisht në korridoret e godinës nr.2, në katin e parë. Gjithashtu gjatë këqyrjes së pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, duket që në orën 19:00, të datës 13.02.2022, në sektorin nr.2, kati i parë, godina nr.2, futet grupi i sigurisë së institucionit për të ndarë nga konflikti fizik të dënuarin Imer Jupa me bashkëvuajtësin e tij, të dënuarin Jetmir Llanaj. Ata fillimisht hyjnë në korridorin ngjitur me dhomën nr.8 ku ishin duke u konfliktuar të dy bashkëvuajtësit, dhe më pas i shoqërojnë menjëherë në dhomat e observimit në godinën nr. 5, kati i parë. Sipas pamjeve filmike, grupi i sigurisë e shoqëron të burgosurin Imer Jupa në dhomën nr.15 të observimit në orën 19:31. Në këtë moment 2 punonjës policie futen në dhomë bashkë me të dënuarin Imer Jupa dhe qëndrojnë 2 minuta në dhomë. Në orën 19:33, punonjësit e policisë largohen nga dhoma nr. 15 dhe dalin nga sektori.

Nga njohja me pamjet filmike të kamerave të sigurisë u konstatua se, dy punonjësit e policisë kanë qëndruar në dhomën nr.15 të observimit për dy minuta, pasi kishte hyrë i dënuari Imer Jupa, konkretisht nga ora 19:31 deri në orën 19:33 minuta, dhe pastaj janë larguar. Në këtë hark kohor nuk mund të shikohet se çfarë ka ndodhur në këtë ambient. Sipas informacionit të shefit të policisë këto minuta të qëndrimit të punonjësve të policisë kanë qenë për shkak të mos dëmtimit të të dënuarit, pasi ai ishte agresiv dhe shfrytëzonte raste të tilla për vetëdëmtim.

Referuar informacionit të marrë në IEVP Reç, por edhe nga hetimi i datës 18.03.2022 për pretendimin për ushtrim dhune ndaj të dënuarit Imer Jupa, u konstatuan mungesa në organikën e personelit shëndetësor dhe social, që ndikojnë në cilësinë e shërbimit që ofrojnë këta dy sektorë, në trajtime psiko-sociale, me qëllim uljen e stresit dhe të ankthit, dhe organizime të aktiviteteve specifike me programe të veçanta për të burgosurit dhe si rrjedhojë zvogëlohet edhe mundësia për të parandaluar rastet e vetëvrasjeve për të dënuarit¹. Këto konstatime janë bërë edhe nga ndihmëskomisionerët e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, gjatë inspektimit që ata kanë kryer në datën 29.09.2021 në IEVP Reç, Malësi e Madhe, Shkodër².

Pas hetimit administrativ të ankesës së të dënuarit Imer Jupa, drejtuar institucionit tonë dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar lidhur me këtë rast, konstatojmë se:

¹ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të plotësojë organikën e IEVP-ve me punonjës sipas kritereve të përcaktuara në Urdhërin Nr.6783, datë 13.11.2017 të Ministrit të Drejtësisë.

² Rekomandim dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. K4/I51-2 prot, datë 24.11.2021 ku ndër të tjerat thuhet: “Plotësimi i organikës të sektorit me punonjës psikolog/punonjës social; shtimin e kontakteve të vazhdueshme dhe periodike të stafit psiko-social me të burgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi; si dhe nxitjen e organizimin e aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive”.

1. Për sa më lart, ka patur neglizhencë të stafit shëndetësor të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Reç, për kryerjen e kontrollit të vazhdueshëm shëndetësor të të burgosurit, i cili pretendon se ndaj tij është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë, si dhe për lënien e shënimeve përkatëse në kartelën klinike të tij, qoftë edhe në rastin kur tek ai nuk konstatohet asnjë dëmtim apo lëndim fizik.

Nga mbikëqyrja e dokumenteve të sektorit shëndetësor për të dënuarin Imer Jupa, rezulton se ai është diagnostikuar me diagnozën çrregullim personaliteti dhe sjellje impulsive.

Për rastin në fjalë, i dënuari Imer Jupa gjatë qëndrimit në dhomën e observimit të IEVP Reç është trajtuar nga ana e stafit mjekësor, duke kryer kontrole periodike mjekësore (referohet në kontrole mjekësore që nuk lidhen me rastin e përdorimit të forcës fizike ose të vetëdëmtimit të të dënuarit).

Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin osë Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) në datën 17.09.2019, ka bërë publik raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 nëntor deri në datën 30 Nëntor 2018³. Në pjesën e raportit që ka të bëjë me IEVP-të, shkronja C, pika 4, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për stafin shëndetësor në lidhje me dokumentimin e dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të dhunës, që sipas CPT-së nuk janë të hollësishme. Në mënyrë të përmbledhur po rendisim rekomandimet e CPT ku thuhet se:

Së pari, procesverbali i përpiluar pas ekzaminimit mjekësor të një të burgosuri duhet të përmbajë një përmbledhje të plotë të gjetjeve mjekësore të bazuara në këqyrjen fizike si:

(i)shënimin e dëmtimeve traumatike dhe mundësisht fotografitë e dëmtimeve.
(ii) deklaratimet e të burgosurit që janë të rëndësishme për ekzaminimin mjekësor.

(iii)mendimin e mjekut në varësi të gjetjeve mjekësore objektive dhe deklaratimeve. Procesverbali gjithashtu duhet të përmbajë rezultatet e ekzaminimeve shtesë të kryera, përfundimeve të hollësishme të mjekut specialist dhe një përshkrim të trajtimit të dhënë për dëmtimet. Rezultatet e secilit prej ekzaminimeve dhe rezultatet e mjekut duhet të vendosen në dispozicion të të dënuarit/të të paraburgosurit dhe mbrojtësit të tij ligjor.

³ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

Së dyti, sa herë që dëmtimet regjistrohen nga një punonjës i stafit shëndetësor sipas pretendimeve të të dënuarit/ të të paraburgosurit për keqtrajtim (ose që, edhe në mungesë të pretendimeve, janë tregues i keqtrajtimit), rasti i raportohet prokurorisë, pavarësisht dëshirës së personit në fjalë. Stafi shëndetësor duhet ta vërë në dijeni të dënuarin/ të paraburgosurin për detyrimin ligjor të mjekut për raportimin dhe se ky raportim nuk zëvendëson paraqitjen e një ankese nga vetë i dënuari/ i paraburgosuri.

Së treti, personeli mjekësor që punon pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, duhet të ketë në vëmendje detyrimin ligjor që të raportojë, brenda 48 orëve, përpara prokurorit kompetent çdo lëndim apo dëmtim që është një tregues i përdorimit të dhunës.

Sipas deklarimeve të të dënuarit Imer Jupa, ai në disa raste ka bërë tentativa për vetëdëmtim për shkak të stresit të krijuar dhe mërzisë. Sektori shëndetësor dhe ai psiko-social nuk i kanë ardhur në ndihmë për parandalimin e këtyre sjelljeve, që sjellin çrregullim thelbësor të mendimit, perceptimit, orientimit, si dhe dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, por janë mjaftuar vetëm me dhënien e qetësuesve dhe vënien në gjumë të personit. Në këtë rast të dy sektorët duhet të funksionojnë në mënyrë multidisiplinare me qëllim zvogëlimin e mundësisë për rastet e vetëvrasjes, këshillimin, riintegrimin si dhe nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të burgosurit.

2. Moszbatimi i urdhërit nr.6783 datë 13.11.2017 të Ministrit të Drejtësisë për plotësimin e organikës me punonjës psikolog/punonjës social si dhe mosorganizimi dhe mos vënia në punë në mënyrë eficiente e sektorit psiko-social në këtë institucionon do të krijojnë ngarkesë psikologjike, emocionale deri në çrregullimin të personalitetit të të burgosurve.

Në ligjin nr.81/2020 datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në nenin 40/1 përcaktohet se trajtimi social-edukativ i të burgosurit zhvillohet me anë të aktiviteteve individuale dhe veprimtarive formuese. Trajtimi realizohet nga personeli i institucionit, që ka formimin e duhur në fushën përkatëse dhe aftësi profesionale, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se komunikimi me anëtarët e familjes dhe personat e tjerë jashtë institucionit inkurajohet dhe sigurohet në përputhje me planin individual të trajtimit dhe programet e trajtimit, të rehabilitimit dhe të riintegrimit, me përjashtim të rasteve kur zbatohet regjimi i posaçëm sipas nenit 17 të këtij ligji.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar i kërkon në mënyrë të përsëritur Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Reç dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve plotësimin e stafit psiko-social sipas ligjit dhe akteve ligjore në fuqi dhe ofrimin e shërbimit psiko-social nga ana punonjësve të edukimit, duke ofruar asistencën e tyre çdo ditë me frekuencë 4 orë, nëpërmjet bisedave dhe aktiviteteve me të burgosurit. Kjo do të krijonte një klimë të sigurt që ushqen besim reciprok, u krijon të dy palëve në komunikim të ndiejnë përgjegjësi, u ofron më shumë liri zgjedhjeje dhe si rezultat u mëson të kenë më shumë aftësi sociale. Gjatë gjithë kohës nga ana e stafit të kujdesit social duhet të zhvillohen tema të ndryshme për të përballuar presionin e grupit, për të përvetësuar aftësitë dhe për t'u përshtatur me jetën e re sociale. Nga ana e psikologëve të institucionit duhet të zhvillohen biseda këshilluese çdo ditë, sidomos me personat që paraqesin probleme psikologjike, si dhe ata të cilët kanë probleme me përshtatjen me rregullat dhe kushtet e burgut.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor të institucionit me 2 mjekë të përgjithshëm me kohë të plotë, 1 farmacist dhe 2 infermierë, me qëllim garantimin e shërbimit shëndetësor për pacientët e sëmurë kronik dhe të burgosurit; riorganizimin dhe vënien në punë në mënyrë më eficiente të sektorit psiko-social të institucionit; plotësimin e organikës të sektorit me punonjës psikolog/punonjës social për të ofruar shërbim psiko-social për të burgosurit me qëllim rehabilitimin, këshillimin, ri-integrimin si dhe nxitjen e organizimit dhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të burgosurit.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga punonjësit e stafit shëndetësor të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Reç, për kryerjen e kontrollit të vazhdueshëm shëndetësor të të burgosurit, ndaj të cilit është ushtruar dhunë fizike dhe lënien e shënimeve përkatëse në kartelën klinike të tij, qoftë edhe në rastin kur tek ai nuk konstatohet asnjë dëmtim apo lëndim fizik.
3. Përgjithësimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në të gjitha IEVP-të dhe informimin e punonjësve të stafit shëndetësor mbi gjetjet e Raportit të CPT-së dhe rekomandimet në lidhje me dokumentimin e dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të përdorimit të forcës.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për riorganizimin dhe vënien në punë në mënyrë më efçente të sektorit psiko-social, për një vëmendje më të veçantë për të burgosurit me çrregullime të personalitetit, në dhënien e ndihmës mjekësore sipas ligjit dhe akteve ligjore në fuqi, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive dhe dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI